



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit

P-89

Prishtinë, më 19 nëntor 2009

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 19 NËNTOR 2009**

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Nuk pati asnjë propozim për amandamentimin të rendit të ditës.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 29 tetor 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për borxhet publike,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hetim parlamentar,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
6. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2008,
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave,
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale,
9. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë të Ekonomisë dhe të Financave për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm ,
10. Njoftimi me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e deputetit Naim Rustemi për respektimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 29 tetor 2009

Deputetja Gjylnaze Syla pati vërejtje teknike në procesverbal, që u korrigjua sipas kërkesës së saj.

Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 29 tetor dhe 2 nëntor 2009, me vërejtjen e deputetes Syla.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Riza Smaka** parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi ose zëvendës kryeministrat Kuçi ose Manaj lidhur me rimbursimin e dëmeve materiale dhe morale të qytetarëve kosovarë.

Zëvendëskryeministri Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Kaqusha Jashari** parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor.

Zëvendëskryeministri **Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Jashari.

Deputeti **Dritan Tali** parashtoi pyetje për kryeministrin e Kosovës se çka e shtyri Qeverinë që kapacitetet e “Kosovës C” të zvogëlohen nga 2000 në 1000 megavat ose tri

here nga 330 apo dy herë nga 500 megavat. Cilat janë arsyet që Qeveria të ndërrojë këtë mendim?

Kryeministri **Thaçi** iu përgjigj pyetje së deputetit Tali.

Deputeti **Dritan Tali** parashtoi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me zbatimin e planit për vendosjen e arkave fiskale të bizneseve kosovare.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Nerxhivane Dauti** parashtoi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me Projektligjin për pastrimin e parave.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputetja **Nerxhivane Dauti** parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq lidhur me Projektligjin për punën.

Ministri **Rashiq** iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputetja **Drita Maliqi** parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me fatin e personave të pagjetur.

Kryeministri **Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputetja **Gjylnaze Syla** parashtoi pyetje për ministrin Mahir Yagcular lidhur me Planin strategjik të ujërave.

Ministri Yagcular iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputetja **Gjylnaze Syla** parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me veprimet për shuarjen e strukturave paralele.

Kryeministri **Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtoi pyetje për ministrin Ahmet Shala lidhur me shpenzimet e PTK-së në donacione dhe sponzorim gjatë vitit 2009.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për borxhet publike

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për borxhet publike.

Ministri **Ahmet Shala** tha se ky Projektligj ofron një kornizë gjithëpërfshirëse dhe i mundëson Kosovës të marrë hua dhe të tërheqë fonde në arenën ndërkombëtare dhe vendore. Huamarrja, përkatësisht Ligji për borxhet publike do t'i mundësojë një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe një dinamikë më të zhvilluar dhe të avancuar të

përmbushjes së objektivave të veta zhvillimore. Përmes këtij ligji, Kosova do të bëhet pjesë e komunitetit financiar ndërkombëtar, sidomos tani që jemi anëtar të barabartë dhe të plotfuqishëm në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore.

Ai theksoi se Ligji për borxhet publike na ndihmon për të rregulluar në mënyrë të qartë marrjen dhe menaxhimin e borxhit publik. Këtë ligj besoj që do ta miratojmë gjithnjë me qëllim që të rregullojmë rrugën e qartë të nivelit të marrjes së kredive, mënyrën e marrjes së kredive, mënyrën e menaxhimit të borxhit dhe prioritetet që ka zgjedhur Qeveria e Kosovës për nevojat e veta zhvillimore.

Në fund, ministri i informoi deputet se nuk ka qenë e lehtë për ta negociuar këtë projektligj me Fondin Monetar Ndërkombëtar, që është dashur dy misione të Fondit Monetar Ndërkombëtar të vijnë në Kosovë për të harmonizuar këtë pjesë, sidomos pjesën për borxhet dhe i ftoi deputet që ta miratojnë, në parim.

Kryetari ftoi kryetarin e komisionit funksional për Buxhet dhe Financa që ta marrë fjalën.

Pasi që nuk pati të paraqitur për fjalë as nga komisioni funksional, as nga komisionet e tjera, **kryesuesi** hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për borxhet publike

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Nergjivane Dauti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, **Enis Kervan**, si dhe deputetët: **Driton Tali**, **Berim Ramosaj**, **Riza Smaka**, si dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, **Ahmet Shala**, të cilat janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për borxhet publike. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----9,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për borxhet publike .

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hetim parlamentar

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta prezantojë Projektligjin për hetim parlamentar.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, tha se Komisioni, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, në Rregullën 33, bazuar në Vendimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, të datës 23.02.2009, ka marrë vendim për të hartuar Projektligjin për hetim parlamentar.

Qëllimi i projektligjit është që t'u japë mundësi komisioneve hetimore parlamentare t'i kenë të qarta përgjegjësitë, funksionimin, organizimin dhe fushëveprimtarinë e vet. Qëllim tjetër dhe rëndësi e veçantë për komisionet hetimore parlamentare është që të jepet mundësia që Kuvendi i Kosovës përmes komisioneve hetimore parlamentare të debatojë në raste të caktuara kur paraqiten afera korruptive, mandej keqmenaxhim në çështje të caktuara, shkelje të dispozitave ligjore, por edhe për çështje të tjera të cilat janë me interes të përgjithshëm jo vetëm për institucionet në Kosovës, por edhe për interesin publik të përgjithshëm.

Ai kërkoi nga deputetët që ta mbështesin Projektligjin, në parim.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për hetimin parlamentar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Kolë Berisha**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar "7+", **Myfera Shinik**, si dhe deputetët: **Sanije Alijaj**, **Edita Tahiri**, **Gjylanze Sylja**, **Bajram Kosumi**, **Riza Smaka**, **Nyrishahe Hulaj**, **Armend Zemaj**, **Nekibe Kelmendi**, **Njomza Emini**, **Gani Buqinca**, **Arsim Bajrami**, **Eqrem Kryeziu** dhe **Bahri Hyseni**, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----1,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për hetimin parlamentar.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ai ftoi kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta arsyetojë Raportin me Rekomandime.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, tha se Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për konfliktin e interesit në leximin e dytë. Me rastin e amendamentimit, në nenin 17 ka qenë një ndryshim teknik nga Zyra për Standardizim dhe ne nuk kemi paraparë si komision që të hartojmë amendament, sepse ka qenë vetëm çështje teknike. Pra, kërkojmë nga deputetët që të mos bien në dilemë, sepse ka qenë një çështje teknike dhe nuk e kemi parë të arsyeshme të bëjmë amendament për çështje teknike dhe kemi lënë që Zyra për Standardizim ta rregullojë çështjen jo përmbajtjesore, por teknike të nenit 17.

Kryetari hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për65,
Kundër..... 0,
Abstenime..... 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

6. Shqyrtimi i Raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për vitin 2008

Kryetari i njoftoi deputetët se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, në pajtim me Rregullën nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores për Shërbimin Civil, ia ka paraqitur Kuvendit raportin vjetor për vitin 2008.

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008 dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008 dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Kryetari hapi debatin për Raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hydajet Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Melihate Termkolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, **Shpresa Murati**, si dhe deputetët: **Sanije Alijaj, Gani Geci, Naser Rugova, Gjylnaze Syla, Rita Hajzeraj dhe Gani Buqinca**, të cilat janë dhënë në transkript, që është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e Raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër-----0,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave

Kryetari njoftoi deputetët se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e datës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta marrë fjalën.

Ministri i Administratës Publike, **Arsim Bajrami**, tha se në Kosovë nuk është bërë regjistrimi i popullsisë që nga viti 1981. Me gjithë zhvillimet shumë të vullshme demografike në vend, ka theksuar se Qeveria propozon që regjistrimi të kryhet nga 30 marsi deri më 11 prill të viti 2011. Si fakt inkurajues është edhe përfshirja e komuniteteve në regjistrim dhe mbështetja e projektit nga EUROSTAT-i, kurse për kryerjen me sukses të regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave do të trajnohen rreth tetë mijë njerëz.

Në emër të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, deputeti **Hajredin Hyseni** tha se Komisioni i kishte rekomanduar Kuvendit që regjistrimi i popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave të fillojë më 30 mars deri më 15 prill 2010. Mirëpo, pas udhëzimeve të Kryesisë së Kuvendit që ky komision të harmonizojë datën e mbajtjes së regjistrimit me Qeverinë, komisioni ka bërë konsultimet me Ministrinë

e Administratës Publike dhe pas dëgjimit të fakteve që ka paraqitur ministria, komisioni në një mbledhje të veçantë është pajtuar me shumicën e deputetëve të komisionit që vendimi i Qeverisë të përkrahet dhe regjistrimi i popullsisë të jetë më 30 mars deri më 11 prill 2011.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim-vendim dhanë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Avdiu**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Melihate Termkolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së **Ibrahim Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Gjylnaze Syla**, kryetari i Kuvendit **Jakup Krasniqi**, **Mark Krasniqi**, **Armend Zemaj**, **Riza Smaka**, **Sabri Hamiti** dhe **Ali Lajqi**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për caktimin e datës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave . Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,
Kundër-----1,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e datës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave

Regjistrimi i popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave do të mbahet prej 30 mars deri më 11 prill 2011.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale

Kryesuesi njoftoi deputet se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Kryetari ftoi kryetarin ose përfaqësuesin a raportuesin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa që ta marrë fjalën.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeti **Armend Zemaj** tha se në bazë të Ligjit nr. 03/L-034, i ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/20, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe në bazë të Rregullës 51.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2009 me përfaqësuesit, anëtarët e Bordit të

Trustit Pensional ka shqyrtuar propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe njëkohësisht vlerëson se propozimi për uljen e taksës për qeverisjen e mjeteve të besuara të kursimit pensional në 0.8, nuk paraqet pengesë për funksionimin e Trustit, por krijon të hyra me të cilat sigurohet ruajtja e cilësisë së punës dhe të shërbimeve që i ofron Trusti.

Me qëllim të operacionalizimit financiar të Trustit për uljen e taksës administrative nga 0.90, sa ka qenë, në 0.80 nga shuma e mjeteve duke filluar nga 1 janari i vitit 2010, Komisioni rekomandon që të miratohet propozimi i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe njëkohësisht edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështesim këtë propozim dhe këtë rekomandim të Komisionit.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Propozim-vendimit e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryesuesi e hodhi në votim Propozim-vendimit Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Propozim-vendimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të kursimeve pensionale.

9. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë të Ekonomisë dhe të Financave për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm

Kryetari i njoftoi deputet se Ministria e Ekonomisë dhe të Financave ka kërkuar nga Kuvendi ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e saj në seancë plenare.

Kryesuesi ftoi kryetarin ose raportuesin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta marrë fjalën.

Deputetja **Stafete Hadergjonaj** tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2009, shqyrtoi kërkesën e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm si dhe

kërkesën e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për rritjen e numrit të auditorëve dhe ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës që ta miratojë kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për rritjen e numrit të auditorëve në 16 dhe ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore prej 93.541 euro për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm sipas kërkesës e cila është adresuar.

Po ashtu, Komisioni ka kërkuar që Ministria e Ekonomisë dhe Financave të bëjë harmonizimin e kësaj kërkeje brenda tabelave buxhetore të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-vendim dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputetja: **Vezira Emrush**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----52,
Kundër-----7,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

10. Njoftimi me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e deputetit Naim Rrustemi për respektimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryetari i njoftoi deputetët se në pajtim me nenin 67.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3 nëntor 2009, (me kërkesë të deputetit Naim Rrustemi), vendosi që të kërkohet nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët ushtrojnë ndonjë funksion shtesë, përkatësisht që mbajnë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, e që është në kundërshtim me nenin 72 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 13 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe të nenit 26.1 dhe 27 të Ligjit kundër korrupsionit, të japin dorëheqje nga ato pozita.

Seanca i përfundoi punimet në orën 17: 25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**